

The text in Albanian follows the text in English.

Teksti në shqip vjen pas tekstit në anglisht.

Press release

For immediate release

10 September 2026

UNOPS and OBP Partner to Modernize and Strengthen Centralized Procurement in Albania

TIRANA, 10 September 2026.– The United Nations Office for Project Services (UNOPS) and the Central Purchasing Operator (OBP) of Albania signed a cooperation agreement on 8 September 2026 to implement a six-month technical support project. This partnership underscores a shared commitment to strengthening the strategic direction and operational efficiency of Albania’s public procurement landscape.

The signing ceremony, held at the Pyramid of Tirana, marks a significant step in the ongoing efforts to modernize public procurement processes across the country. Through this project, UNOPS will provide technical expertise to support the OBP in achieving greater efficiency, and international standard alignment in procurement activities.

In her remarks, **Delina Ibrahimaj, Minister of Economy and Innovation**, said that the agreement will help OBP improve its processes, strengthen its capacities and make greater use of technology, including Artificial Intelligence. “This means faster and more transparent procurement, lower costs and better use of public funds – ensuring that every lek spent delivers greater value for citizens. The next step is to

integrate Artificial Intelligence into public procurement processes, with the aim of making this a reality by autumn next year,” Minister Ibrahimaj emphasized.

Jonaid Myzyri, Administrator of the Centralized Purchasing Operator, emphasized that the cooperation will enable OBP to integrate international good practices into its systems, modernize its processes and ensure that public funds are managed according to the highest standards of integrity, transparency and accountability.

“This agreement represents a special moment for our cooperation with the Central Purchasing Body,” said **Sabine Kania, Head of Office, UNOPS Albania & Kosovo.** “By combining UNOPS’ global experience in project management and procurement with the OBP’s strategic vision, we build a solid foundation for more transparent and efficient public procurement that will ultimately benefit the people of Albania.”

Effective public procurement is fundamental to strong institutions and ensuring that public resources deliver quality services for people,” said **Ingrid Macdonald, United Nations Resident Coordinator in Albania.** “Through this partnership, UNOPS will provide international expertise to support the Central Purchasing Operator in strengthening institutional capacity and performance, in line with international standards and good practices. This initiative is an important step towards more effective, transparent and accountable public procurement, supporting better public service delivery and Albania’s continued progress on its European Union integration path.”

The project, which will run for the next six months, focuses on building the capacity of OBP personnel and refining internal mechanisms to enhance the quality and accessibility of public services. The ceremony concluded with both parties reaffirming their dedication to fostering sustainable development and inclusive growth through modernized public infrastructure and services.

ENDS

Notes to the editors:

About the Central Purchasing Operator (OBP)

The Centralised Purchasing Operator (OBP) is a state-owned joint-stock company established by the Council of Ministers to carry out public procurement procedures on behalf of the Prime Minister's Office, ministries and subordinate institutions. OBP aims to strengthen the efficiency, professionalism and transparency of public procurement through the centralisation and standardisation of procurement processes and the provision of specialised procurement services.

<https://obp.al/en/home/>

About UNOPS

UNOPS mission is to help people build better lives and countries achieve peace and sustainable development. We help the United Nations, governments and other partners to manage projects, and deliver sustainable infrastructure and procurement in an efficient way. Read more: www.unops.org

Press contact details:

Rikeda Balliu, Communications Focal Point, UNOPS in Albania
rballiu@unops.org | Phone: +355 69 72 20 138

Njoftim për Shtyp
10 shtator 2026

UNOPS dhe OBP bashkëpunojnë për modernizimin dhe fuqizimin e prokurimit të përqendruar në Shqipëri

TIRANË, 10 shtator 2026.– Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) dhe Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) nënshkruan më 8 shtator 2026 një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e një projekti gjashtëmujor të asistencës teknike. Ky partneritet pasqyron angazhimin e përbashkët për forcimin e drejtimit strategjik dhe rritjen e efikasitetit operacional të prokurimit publik në Shqipëri.

Ceremonia e nënshkrimit, e zhvilluar te Piramida e Tiranës, shënon një hap të rëndësishëm në përpjekjet e vazhdueshme për modernizimin e proceseve të prokurimit publik në vend. Në kuadër të këtij projekti, UNOPS do të ofrojë ekspertizë teknike për të mbështetur OBP-në në rritjen e efikasitetit dhe përafrimin e mëtejshëm të praktikave të prokurimit me standardet ndërkombëtare.

Në fjalën e saj, **Delina Ibrahimaj, Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit**, u shpreh se marrëveshja do të ndihmojë OBP-në të përmirësojë proceset, të forcojë kapacitetet dhe të zgjerojë përdorimin e teknologjisë, përfshirë Inteligjencën Artificiale. “Kjo do të thotë prokurime më të shpejta dhe më transparente, kosto më të ulëta dhe përdorim më të mirë të fondeve publike – duke siguruar që çdo lek i shpenzuar të krijojë më shumë vlerë për qytetarët. Hapi i radhës është integrimi i Inteligjencës Artificiale në proceset e prokurimit publik, me synimin që kjo të bëhet realitet deri në vjeshtën e vitit të ardhshëm,” **theksoi Ministrja Ibrahimaj.**

Jonaid Myzyri, Administrator i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, theksoi se bashkëpunimi do t'i mundësojë OBP-së të integrojë praktikat e mira ndërkombëtare në sistemet e saj, të modernizojë proceset dhe të sigurojë që fondet publike të menaxhohen sipas standardeve më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

"Kjo marrëveshje përfaqëson një moment të veçantë në bashkëpunimin tonë me Operatorin e Blerjeve të Përqendruara," tha **Sabine Kania, Drejtuese e Zyrës së UNOPS për Shqipërinë dhe Kosovën.** "Duke ndërthurur përvojën globale të UNOPS në menaxhimin e projekteve dhe prokurimin me vizionin strategjik të OBP-së, po ndërtojmë një bazë të fortë për një prokurim publik më transparent dhe efikas, që në fund do të sjellë përfitime për qytetarët e Shqipërisë."

"Prokurimi publik efektiv është thelbësor për institucione të forta dhe për të siguruar që burimet publike të përkthehen në shërbime cilësore për qytetarët," tha **Ingrid Macdonald, Koordinatore e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.** "Përmes këtij partneriteti, UNOPS do të ofrojë ekspertizë ndërkombëtare për të mbështetur Operatorin e Blerjeve të Përqendruara në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e performancës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira. Kjo nismë është një hap i rëndësishëm drejt një prokurimi publik më efektiv, transparent dhe të përgjegjshëm, duke kontribuar në ofrimin e shërbimeve publike më cilësore dhe në përparimin e mëtejshëm të Shqipërisë në rrugën drejt integritetit në Bashkimin Evropian."

Projekti, i cili do të zbatohet gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, do të fokusohet në forcimin e kapaciteteve të stafit të OBP-së dhe përmirësimin e mekanizmave të brendshëm, me synim rritjen e cilësisë dhe aksesueshmërisë së shërbimeve publike. Ceremonia u përmbyll me riafirmimin nga të dyja palët të angazhimit për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës përmes modernizimit të proceseve dhe shërbimeve publike.

Fund

Shënim për Redaktorët

Rreth Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP)

Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) është një shoqëri aksionare në pronësi të shtetit, e themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave, me përgjegjësi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në emër të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre. OBP synon të rrisë efikasitetin, profesionalizmin dhe transparencën në prokurimin publik përmes centralizimit dhe standardizimit të proceseve të prokurimit dhe ofrimit të shërbimeve të specializuara në këtë fushë. <https://obp.al/>

Rreth UNOPS

Misioni i UNOPS është të ndihmojë njerëzit të ndërtojnë jetë më të mira dhe vendet të arrijnë paqe dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ne ndihmojmë Kombet e Bashkuara, qeveritë dhe partnerë të tjerë të menaxhojnë projektet dhe të ofrojnë infrastrukturë dhe prokurim të qëndrueshëm në një mënyrë efikase. Lexoni më shumë: www.unops.org

Kontakti për media:

Rikeda Balliu, Specialiste Komunikimi, UNOPS Shqipëri
rballiu@unops.org | Phone: +355 69 72 20 138